



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 713/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10. 2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit KVO-së datë 27.07.2018 për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomik “Drini-1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73904-06-07-2018, me objekt: “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “U. Matit – Rrëshen (Ura e Fanit), Rrëshen (U. Fanit) – Shpal, Shpal – Q. Benë – K. Hadroj, Shpal – Ura e Repsit 84.9 Km*”, me fond limit 64.859,900 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

Ankimues: BO “Drini-1” sh.p.k & “AEK Munella” sh.p.k
Adresa: Rruga “Imer Puka”, Blloku Nr. 03, Banesa Nr. 40, Kati I-re, Pasuria Nr. 1150, Zk 3069, Pukë.
Adresa: Lagjia “Gjakëz”, ndërtesa me nr. Pasurie 40, Zk. 1717, Mirditë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.
Adresa: Rruga “At Zef Valentini”, Lagjia “3 Heronjt”, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit*”

Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga ankimuesi, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.06.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73904-06-07-2018, me objekt: “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “U. Matit – Rrëshen (Ura e Fanit), Rrëshen (U. Fanit) – Shpal, Shpal – Q. Benë – K. Hadroj, Shpal – Ura e Repsit 84.9 Km”, me fond limit 64.859,900 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

II.2 . Në datën 09.07.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 27.07.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën Nr. 356 prot, datë 24.08.2018, rezulton si më poshtë vijon:

1. “Adem Pojani”	pa ofertë	I skualifikuar
2. “Alb Shpresa” shpk	pa ofertë	I skualifikuar
3. “AEK Munella” shpk	pa dokumentacion	I skualifikuar
4. BO “Drini – 1” & “AEK Munella” shpk	55,536,492 lekë	I skualifikuar
5. BO “Ekskluziv” & “Mela” shpk	60,285,426 lekë	I kualifikuar
6. “Florida” shpk	63,002,558 lekë	I skualifikuar
7. “Geci” shpk	63,555,998 lekë	I skualifikuar

II.4. Më datë 27.07.2018, Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Drini – 1” & “AEK Munella” shpk është njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se:

1- *Bilancet kontabel te viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini-1” nuk janë të shoqëruara nga raportet e audituara.*

2- *Akt marrveshja nr. 3850 Rep, Nr. 793 Kol, datë 26.06.2018 ku shënohet ndarja: “AEK Munella” me 49% dhe “Drini-1” me 51 %, ndarja e makinerive nuk është bërë sipas përqindjes së kontratës së bashkëpunimit, konkretisht për mjetet e punës borëpastruese.*

II.4.1. Në datën 02.08.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Drini – 1” & “AEK Munella” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për s’kualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

1- *Përsa i përket çështjes së parë ku bilancet e viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini-1” shpk nuk janë të shoqëruar nga raporti i auditimit mendojmë se kjo nuk qëndron për këto arsyeje: Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 pika 7 “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare deh ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: kopje të çertifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, kriter i cili është plotësuar nga ana jonë, pasi bilancet e dorzuar janë të çertifikuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër. Bilanci nuk mund të certifikohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nëse nuk është kryer raporti i auditimit të pavarur. Mos paraqitja e raportit nga ana jonë ka qënë një gabim teknik por që nuk përbën kushte për të refuzuar ofertën.*

2- *Përsa i përket çështjes së dytë ndarjes së kapacitetit teknik të makinerive, në kontratën e bashkëpunimit B.O ka bashkuar kapacitetin teknik, ekonomik dhe njerëzor në shërbim të realizimit të kontratës dhe nuk kemi bërë ndarje fiktive të mjeteve. Të gjitha mjetet janë në shërbim të*

kontratës dhe të pa angazhuar në kontrata të tjera. Argumentimi i autoritetit kontraktore për ndarjen e makinerive në bazë të përqindjes të kontratës së bashkpunimit nuk përbën kushte për skualifikimin e ofertës.

Në mbështetje të argumentave të mësipërme kemi dhe sa më poshtë:

Në ligjin nr 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 53 pika 4 parashikohet “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”. Në nenin 55 gërma a “Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët”. Në mbështetje të nenit 55, oferta jonë është 4,748,943 lekë më pakë se oferta e shpallur fituese nga Komisioni i Vlersimit të Ofertave. Në këto kushte refuzimi i ofertës sonë është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj, kërkojmë pranimin e kërkesës dhe rivlersimin e ofertës sonë.

II.4.2. Në datën 08.08.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 331 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.4.3. Në datën 15.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 24.08.2018 me anë të shkresës nr. 356 prot, protokolluar me tonën me shkresën nr. 1396/2 prot, datë 29.08.2018, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatojmë se autoriteti kontraktor bashkëlidhur me shkresën Nr. 356 prot., datë 24.08.2018, ka përcjellë edhe vendimin Nr. 07.08.2018 të KSHA mbi ankesën BOE ankimues “Drini – 1” & “AEK Munella” shpk sh.p.k., ku është shprehur si më poshtë vijon:

- *Në lidhje me vlerësimin e bërë nga KVO, për këtë objekt ju jeni skualifikuar me këtë argumentim:*
 - *Bilancet kontabël të viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini -1”shpk nuk janë të shoqëruara me raportet e audituara.*
 - *Aktmarrëveshja Nr. 3850 rep, Nr. 793 Kol, datë 26.06.2018 ku shënohet ndarja : “AEK Munella” me 49% dhe “Drini 1” me 51%, ndarja e makinerive nuk është bërë sipas përqindjes së kontratës së bashkëpunimit, konkretisht për mjetet e punës borëpastruese.*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ju përcjell këtë argumentim:

Neni 46 i LPP, gërma “c”, përcakton se për të vërtetuar gjëndjen ekonomike dhe financiare: “operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të

përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

Neni 28, pika 4 e VKM-së përcakton se: Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse;

Ligji Nr. 10091, dt. 05.03.2009 “për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, gërma “a” ngarkon me detyrim të gjitha shoqëritë tregëtare, pavarësisht nga forma e tyre ligjore.

Për më tepër, anëtarët e KVO në cdo rast vlerësojnë atë dokumentacion i cili është ngarkuar në sistem dhe në rastin konkret raportet e auditimit nuk janë ngaruar fare.

Argumentimi për pikën 2 vijon si më poshtë :

Neni 74 i VKM-së « Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”...

Operatori në fjalë, vlerësohet se nuk e përmbush kriterin e sipërpërmendur....

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues se [...] Operatori ekonomik “Drini – 1” & “AEK Munella” sh.p.k. Përsa i përketë çështjes së parë ku bilancet e viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini-1” shpk nuk janë të shoqëruar nga raporti i auditimit mendojmë se kjo nuk qëndron për këto arsyeje: Në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 pika 7 “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, kriteri i cili është plotësuar nga ana jonë, pasi bilancet e dorzuar janë të certifikuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër. Bilanci nuk mund të certifikohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nëse nuk është kryer raporti i auditimit të pavarur. Mos paraqitja e raportit nga ana jonë ka qënë një

gabim teknik por që nuk përbën kushte për të refuzuar ofertën”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2.2.2 nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë dy viteve të fundit 2016, 2017. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të dy viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuar nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me akt ekspertizën e kryer nga eksperti kontabël i autorizuar.*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes “Drini – 1” sh.p.k. & “AEK Munella” sh.p.k. ka dorëzuar:

- Pasqyrat Financiare viti 2016 të operatorit ekonomik “Drini – 1” sh.p.k., të konfirmuara nga autoritetit përkatës.
- Pasqyrat Financiare viti 2017 të operatorit ekonomik “Drini – 1” sh.p.k., të konfirmuara nga autoritetit përkatës
- Pasqyrat Financiare viti 2016 të operatorit ekonomik “AEK Munella” sh.p.k., të konfirmuara nga autoritetit përkatës.
- Pasqyrat Financiare viti 2017 të operatorit ekonomik “AEK Munella” sh.p.k., të konfirmuara nga autoritetit përkatës

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.5. Në nenin 41, shkronja “c” të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, parashikohet shprehimisht se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 40 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 30 milionë lekësh; 6

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Drini – 1” & “AEK Munella” sh.p.k. lidhur me bilancet e viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini-1”, rezulton se ky i fundit nuk ka paraqitur raportet e auditimit të pavarur, nga ekspert kontabël i autorizuar, për Bilancet e viteve 2016, 2017 të shoqërisë “Drini -1”sh.p.k. Në interpretim të dispozitave ligjore sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se operatori ekonomik ka detyrimin për auditimin e pasqyrave financiare pasi është në kushtet e përmbushjes në mënyrë kumulative të dy prej kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, më konkretisht të xhiros vjetore dhe të totalit të aktiveve. Argumenti i ankimuesit “[...]Mos paraqitja e raportit nga ana jonë ka qënë një gabim teknik por që nuk përbën kushte për të refuzuar ofertën, nuk justifikon mungesën e dokumentacionit të përcaktuar në DT. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Drini – 1” & “AEK Munella” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se [...] Operatori ekonomik “Drini – 1” & “AEK Munella” sh.p.k. “Përsa i përket çështjes së dytë ndarjes së kapacitetit teknik të makinerive, në kontratën e bashkpunimit B.O ka bashkuar kapacitetin teknik, ekonomik dhe njerëzor në shërbim të realizimit të kontratës dhe nuk kemi bërë ndarje fiktive të mjeteve. Të gjitha mjetet janë në shërbim të kontratës dhe të pa angazhuar në kontrata të tjera. Argumentimi i autoritetit kontraktore për ndarjen e makinerive në bazë të përqindjes të kontratës së bashkpunimit nuk përbën kushte për skualifikimin e ofertës.

Në mbështetje të argumentave të mësipërme kemi dhe sa më poshtë:

Në ligjin nr 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në nenin 53 pika 4 parashikohet “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”. Në nenin 55 gërma a “Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët”. Në mbështetje të nenit 55, oferta jonë është 4,748,943 lekë më pakë se oferta e shpallur fituese nga Komisioni i Vlersimit të Ofertave. Në këto kushte refuzimi i ofertës sonë është i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj, kërkojmë pranimin e kërkesës dhe rivlersimin e ofertës sonë” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2.3.7 nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshmeteknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe makineritë që ka në dspozicion apo mund ti vihet në dispozicion operatorit ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kamion 8-12ton)	në pronësi ose me qira	Copë 6
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Mjet per vendosje parrakesh metalik (guardrails)i Batipal	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Borepastruese	në pronësi ose me qira	Copë 6
9	Kamioncine mbi 1 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
10	Fadrome 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 3
11	Ekskavator me zinxhir 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fabrike Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore ose (kontrate furnizimi per asfaltobeton).	pronësi /qira/furnizim	Copë 1
13	Set semaforesh per menaxhim trafiku	pronësi /qira/furnizim	Copë 1

Operatori të paraqese një deklaratë sipas shtojcës Nr.9. Deklarata e mësipërme është objekt verifikimi dhe kontrolli në çdo kohë deri në realizimin e plotë të kontratës.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur janë ne pronesi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi), çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).*
- b) *Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur janë ne pronesi duhet te paraqitet kontrata e blerjes, c' doganimi ne Shqiperi ose (kalimi ne regjim te perkohshme) dhe faturat tatimore perkatese.*
- c) *Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi) çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj dhe te mos jene te nenshkruara perpara janarit te vitit 2018.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Per sa ju perket mjetve borepastruese duhet te jene te paisura me kripore dhe thike (ku te komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo te jene te improvizuara si mjete borepastruese duke bere bashkim pjesesh per te improvizuar borepastruese).*
- g) *Per mjetet borepastruese ne lejet e qarkullimit te tyre duhet te jete e cilesuar si APV (automjet i perdorimit te vecante).*
- h) *Mjetet borepastruese duhet te shoqerohen minimalisht me nga dy foto ku te dallohen qartesisht edhe target e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.*

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Drini – I" & "AEK Munella" sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Aktmarrëveshja Nr. 3850 rep, Nr. 793 Kol, datë 26.06.2018 ku shënohet ndarja: "AEK Munella" me 49% dhe "Drini I" me 51% dhe pjesmarrja në zbatimin e kontratës do të jetë sipas përqindjes dhe zërave të mëposhtëm:

- kategoria e punimeve: drenazhim dhe pastrim
- kategoria e punimeve: riparime të vogla në shtresa, bankina dhe strukturë.
- kategoria e punimeve: mirëmbajtje dimërore
- kategoria e punimeve: ditë pune

“AEK Munella”	49%
“Drini 1”	51%

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.2.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.2.5. Në nenin 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*.

“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”.

“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

III.2.6. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Drini – I” & “AEK Munella” sh.p.k. rezulton se, në kontratën e bashkëpunimit të përkohshëm të sipërcituar, është përcaktuar se shoqëria “AEK Munella” sh.p.k., ndër të tjera, ka marrë përsipër zbatimin e shërbimit “*kategoria e punimeve: mirëmbajtje dimërore*”, në masën 49% të volumit. Në këto kushte, referuar pikës 3 të nenit 74 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, detyrimi për të provuar disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për zbatimin e kontratës bie në masën 49% mbi shoqërinë “AEK Munella” sh.p.k. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në përmbushje të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se pjestari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik, “AEK Munella” sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacion në lidhje me mjetin borëpastruese. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar dokumentacionit të paraqitur,

sipas të cilit operatori ekonomik “*AEK Munella*” sh.p.k. si pjesë e bashkimit të përkohshëm ka marrë përsipër të kryejë 49% të volumit, kriteri në lidhje me mjetet nuk mund të konsiderohet i përmbushur, duke mos qenë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Rrjedhimisht, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik “*Drini – 1*” & “*AEK Munella*” sh.p.k. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BO “*Drini-1*” sh.p.k. & “*AEK Munella*” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73904-06-07-2018, me objekt: “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “U. Matit – Rrëshen (Ura e Fanit), Rrëshen (U. Fanit) – Shpal, Shpal – Q. Benë – K. Hadroj, Shpal – Ura e Repsit 84.9 Km*”, me fond limit 64.859,900 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të vazhdojë hapat e mëtejshëm të procedurës.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1396 Protokoli, Datë 25.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha